

[Printo]

[Google Translate]

LIGJ

Nr.10 360, datë 16.12.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10 119, DATË 23.4.2009 "PËR PLANIFIKIMIN E TERRITORIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 92 të ligjit nr.10 119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën "b" të pikës 1, fjalët "jo më vonë se data 15 janar 2011" zëvendësohen me fjalët "jo më vonë se data 30 shtator 2011".
2. Në pikën 3 fjalët "në datën 15 janar 2011" zëvendësohen me fjalët "në datën 30 shtator 2011".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6831, datë 27.12.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Copyright 2012 - www.ligjet.org